

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Profilin Mësimor**

**FLORIKULTURE**  
**Niveli III**

**(Në drejtimin mësimor PYJE)**

**Kodi: S3-III-18**

Miratoi:

MINISTRI

**Tiranë, 2018**

## **Përmbajtja:**

**I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Florikulturë”, niveli III, të drejtimit mësimor “Pyje”.**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Florikulturë”, niveli III.**

1. Kërkesat e pranimet të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Florikulturë”, niveli III
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Florikulturë”, niveli III
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Florikulturë”, niveli III
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Florikulturë”, niveli III.

**III. Plani mësimor për profilin “Florikulturë”, niveli III.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Florikulturë”, niveli III.**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

**X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Florikulturë”, niveli III, të drejtimit “Pyje”.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Florikulturë”, niveli III, të drejtimit “Pyje”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me silvikulturën. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:*

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Florikulturë”, niveli III**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Florikulturë”, niveli III**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Florikulturë” niveli III, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Pyje”, niveli I;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në profilin “Florikulturë”, niveli III**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Florikulturë”, niveli III, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më

efektive dhe më efçente.

- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Florikulturë”, niveli III.**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Florikulturë”, niveli III, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë matje me instrumenta matës gjeodezije dhe llogaritjen e tyre .
- Të kryejë punime dhe matje në ngritjen e lulishteve të vogla.
- Të kultivojë lulet në ambjente të ngrohta dhe ti trajtojë ato.
- Të trajtojë kalemata dhe ti përgatisë ato për mbjellje.
- Të shartojë lulet dhe shkurret dekorative.
- Të përgatisë dherishten dhe të mbushë vazot.
- Të përgatisë preparate kimike dhe ti përdorë ato në lule dhe në parqe.
- Të shumëzojë dhe të mbjellë shkurret dekorative.
- Të piketojë sipërfaqe, të ndërtojë parqe dhe lulishte duke përdorur instrumentat matës të gjeodezisë.
- Të përdorë teknologjitë e tharjes së luleve, bimëve aromatike dhe mjeksore.
- Të kryejë punime mirëmbajtje në lulishte, por edhe në sera të luleve dhe shkurreve dekorative.
- Të piketojë dhe të ndërtojë sistemin e ujitjes së luleve.
- Të përgatisë dhe të trajtojë lulet e prera, si buqeta, kurora, lule për tavolina dhe zbukurime të ndryshme.
- Të përcaktojë hapat e një konvejeri në lultari.
- Të grumbullojë farëra dhe zhardhokë.
- Të përcaktojë tipet e sëmundjeve dhe dëmtuesve dhe ti luftojë ato.
- Të kryejë shërbime në bimët dekorative.
- Të kryejë krasitje të luleve dhe të bimëve dekorative.
- Të zbatojë standardet ndërkombëtare në fushën e florikulturës.
- Të zbatojë kuadrin ligjor që lidhet me florikulturën.

- Të përgatisë dhe të përdorë dokumentacionin teknik dhe financiar të profesionit.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

#### 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Florikulturë”, niveli III.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Florikulturë”, niveli III, e pajis nxënësin me çertifikatën e teknikut të florikulturës. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit të punësohet në drejtoritë e shërbimit pyjor, por edhe të vetpunësohet duke hapur biznesin e tij në fushën e fidanishteve pyjore, kultivimit të luleve, prodhimeve të dyta të pyllit dhe nxjerrjes së produkteve, mbrojtjes së mjedisit pyjor etj. Pas një përvoje pune e trajnimeve të vazhdueshme, ai mund të krijojë një sipërmarrje të vetën duke punësuar edhe individë të tjerë në veprimtarinë e florikulturës.

Me përfundimin e suksesshëm të këtij niveli, nxënësi fiton njëkohësisht edhe diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve të larta universitare si dhe të arsimit pas të mesmes.

### III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Florikulturë”, niveli III (2018-19)

Plani mësimor për profilin “Florikulturë”, niveli III (2018-19)				
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimorë	Orët javorë/vjetorë	
			Klasa 12	Klasa 13
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)</b>	<b>10/11</b> (360/ 396)	<b>14/16</b> (448/ 512)
1		Gjuhë shqipe (dhe Letërsi)	1	2
2		Letërsi	1	-
3		Gjuhë e huaj	2	2
4		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(1)	(2)
5		Histori	1	-
6		Gjeografi	1	2
7		Matematikë	2	2
8		Biologji	-	1
9		Teknologji informimi e komunikimi	1	1
10		Histori arti	-	2
11		Edukim fizik, sporte, shëndet	1	-
12		Lëndë me zgjedhje të detyruar (Fizikë; Kimi; Biologji)	-	2
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale (Gjithsej)</b>	<b>9</b> (324)	<b>10</b> (320)
1	L-17-197-11	Bazat e sipërmarrjes	2	2
2	L-05-198-12	Mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm	-	1
3	L-03-229-11	Topogjeodezi	1	-

4	L-25-335-13	Bazat e lultarisë	2	-
5	L-25-336-13	Ekologjia e luleve.	1	-
6	L-25-337-13	Lulet një dhe dy vjeçare	2	-
7	L-25-338-13	Bimët mjeksore	1	-
8	L-25-339-13	Bimët aromatike dhe eterovajore	-	1
9	L-25-340-13	Drurët dhe shkurret dekorative	-	2
10	L-25-341-13	Lulet shumëvjeçare	-	2
11	L-25-342-13	Mbrojtja e luleve nga sëmundjet dhe dëmtuesit	-	1
12	L-25-234-11	Mbrojtja e natyrës dhe planifikimi i territorit	-	1
<b>C.</b>		<b>Module të detyruara të praktikës profesionale (Gjithsej)</b>	<b>9</b> (324)	<b>6</b> (192)
1	M-25-967-13	Punimet në ngritjen e lulishtes	54	-
2	M-25-968-13	Kultivimi i luleve në shtretër e sera	54	-
3	M-25-969-13	Përgatitja e kalemave për mbjellje.	36	-
4	M-25-970-13	Përdorimi i preparateve kimike	36	-
5	M-25-971-13	Shartimet	36	-
6	M-25-972-13	Përgatitja e dherishtes.	36	-
7	M-25-973-13	Shumëzimi dhe mbjellja e shkurreve dekorative	36	-
8	M-25-646-11	Punimet me instrumenta matës gjeodezije	36	-
9	M-25-974-13	Llogaritjet ekonomike në florikulturë	-	30
10	M-25-975-13	Ndërtimi i një konvejeri në lultari	-	33
11	M-25-976-13	Grumbulli i farërave dhe zhardhokëve	-	33
12	M-25-977-13	Luftimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve	-	30
13	M-25-978-13	Shërbimet në bimët dekorative	-	33
14	M-25-979-13	Krasitja e luleve dhe bimëve dekorative		33
<b>D.</b>		<b>Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)</b>	<b>2</b> (72)	<b>-</b>
1	M-25-980-13	Mirëmbajtja e lulishteve	36	-
2	M-25-981-13	Tharja e luleve dhe bimëve aromatike	36	-
3	M-25-982-13	Ndërtimi i sistemit ujitës te lulet	36	-
4	M-25-983-13	Trajtimi dhe përgatitja e luleve të prera	36	
		<b>Gjithsej A+B+C+D</b>	<b>30/31</b> (1080/ 1116)	<b>30/32</b> 960/ 1024)

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (36 javë mësimore)

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Florikulturë”, niveli III, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

## V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Florikulturë”, niveli III.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Florikulturë”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

## VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Florikulturë”, niveli III, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

a) Provimeve të maturës shtetërore profesionale (sipas udhëzimeve të MASR dhe MFE)

b) Provimit të praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit njohurive nga lëndët teorike, të përgjithëshme dhe profesionale, si dhe të kompetencave profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale të sektorit të silvikulturës. Në përfundim, nxënësve u jepet diploma e maturës shtetërore si dhe certifikata e përgatitjes profesionale, në të cilat evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike të përgjithëshme dhe profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, si dhe rezultatet e provimeve përfundimtare.

## **VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Florikulturë”, niveli III**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Florikulturë, niveli III, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e maturës shtetërore profesionale si dhe me Certifikatën e aftësisë profesionale në nivelin e teknikut/menaxherit në këtë profil profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor;

- rezultatet e provimeve përfundimtare të Nivelit III.



## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-197-11). Kl. 12 – 72 orë dhe kl. 13 - 68 orë

#### • Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes” në kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementët kryesorë të saj
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore
- Të shpjegojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes
- Të shpjegojnë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes
- Të përshkruajnë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të
- Të përshkruajnë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/sherbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje
- Të shpjegojnë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes
- Të shpjegojnë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut
- Të listojnë katër \*P\*-të e marketingut
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

#### • Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 72 orë

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen	3 orë
<b>Tema 2</b>	Sipërmarrja dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
<b>Tema 3</b>	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
<b>Tema 4</b>	Organizimi i punës në biznes	9 orë
<b>Tema 5</b>	Tregu dhe sjellja konsumatore	6 orë
<b>Tema 6</b>	Institucionet financiare	7 orë
<b>Tema 7</b>	Njohuri për Marketingun	5 orë
<b>Tema 8</b>	Legjislacioni dhe etika e biznesit	5 orë
<b>Tema 9</b>	Legjislacioni i punës	7 orë
<b>Tema 10</b>	Llogaritje të thjeshta ekonomike	10 orë
<b>Tema 11</b>	Aspekte të TIK-ut në biznes	4 orë
<b>Tema 12</b>	<i>Detyrë praktike</i> për llogaritjet ekonomike në veprimtarinë profesionale	4 orë

#### • Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit
- Të shpjegojnë kuptimin filozofik të kompanisë dhe misionin i saj në tregun e biznesit.
- Të përshkruajnë aktivitetet e biznesit të kryera nga sipërmarrësit në menaxhimin e biznesit
- Të fitojnë aftësitë themelore dhe teknikat për të udhëhequr dhe menaxhuar një biznes në

kontekst të kërkesave aktuale shoqërore.

- Të dallojnë tiparet dhe aftësitë menaxheriale që lidhen me punën e suksesshme sipërmarrëse.
- Të shpjegojnë funksionet dhe teknikat e menaxhimit.
- Të shpjegojnë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit).
- Të menaxhojnë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës
- Të dallojnë konceptet, sistemet, dhe mjetet e nevojshme për të sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit për vendim-marrjen në biznesin.
- Të shpjegojnë nevojën e vlerësimit të tregut dhe dobinë e marketingut në biznes, si dhe mënyrën për të arritur objektivat e tij.
- Të shpjegojnë konceptet financiare dhe mjetet e përdorura për menaxhimin financiar.
- Të hartojnë një plan efektiv biznesi sipas profilit përkatës.
- Të përshkruajnë procesin e financimit nëpërmjet krijimit të planit të biznesit dhe analizën e burimeve të financimit.
- Të vlerësojnë qëndrueshmërinë ekonomike për të ardhmen e kompanisë.
- Të dallojnë kuadrin ligjor dhe detyrimet përkatëse si pjesë aktive e vendimarrjes në një biznes.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Sipërmarrja dhe menaxhimi	4 orë
<b>Tema 2</b>	Sipërmarrja dhe biznesi	5 orë
<b>Tema 3</b>	Aftësitë menaxheriale	8 orë
<b>Tema 4</b>	Funksionet dhe teknikat e menaxhimit	5 orë
<b>Tema 5</b>	Menaxhimi i burimeve njerëzore	7 orë
<b>Tema 6</b>	Menaxhimi i informacionit	6 orë
<b>Tema 7</b>	Menaxhimi marketing	5 orë
<b>Tema 8</b>	Menaxhimi financiar	9 orë
<b>Tema 9</b>	Zhvillimi i një plani biznesi	7 orë
<b>Tema 10</b>	Objektivat e biznesit dhe treguesit e menaxhimit	7 orë
<b>Tema 11</b>	Kuadri ligjor dhe taksat	5 orë

**2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshem “ (L-05-198-12). Kl. 13 - 32 orë**

• **Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qendrueshem ”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qendrueshem” kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”
- Të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.

- Të pershkruajne kuadrin ligjor dhe institucional nderkombetar, kombetar dhe vendor ne lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qendrueshem.
- Të pershkruajne sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qendrueshem”, kl.13 - 32orë**

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme për mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
<b>Tema 2</b>	Burimet kryesore te mjedisit dhe degradimi mjedisor .	3 orë
<b>Tema 3</b>	Ndikimi i veprimtarise se njeriut ne mjedis .	3 orë
<b>Tema 4</b>	Zhvillimet demografike dhe mjedisi.	3 orë
<b>Tema 5</b>	Shoqeria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
<b>Tema 6</b>	Monitorimi i burimeve mjedisore	3 orë
<b>Tema 7</b>	Kuadri ligjor dhe institucional per mjedisin dhe zhvillimin e qendrueshem	2 orë
<b>Tema 8</b>	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
<b>Tema 9</b>	<u>Veprimtari praktike</u> për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal.	3 orë
<b>Tema 10</b>	<u>Veprimtari praktike</u> për mbrojtjen e mjedisit lokal	6 orë

**3. Lënda “Topogjeodezi” (L-03-229-11), kl. 12 – 36 orë**

• **Synimet e lëndës “Topogjeodezi”, kl 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Topogjeodezi”, klasa12, nxënësit duhet:

- Të pershkruajne formën e tokës, përmasat e saj .
- Të listojnë shembuj të kuotave dhe të tregojnë rolin e tyre.
- Të përcaktojnë madhësitë kryesore që përdoren në punime topografike.
- Të sqarojnë elementet e hartës topografike .
- Të përcaktojnë largësitë në terren mes pikave që jepen në hartë.
- Të përcaktojnë kuotat e pikave që jepen .
- Të masin kënde horizontale dhe vertikale gjatë punimeve të ndryshme.
- Të masin me metër shirit.
- Të masin sipërfaqe të parcelave me metodën grafike.
- Të llogarisin kordinatat në një poligon.
- Të përdorin instrumentat e nivelimit .
- Të përcaktojnë me instrumenta disnivelelin mes dy pikave në terren.
- Të hartojnë planimetrinë kadastrale në shërbim të ekonomisë pyjore.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Topogjeodezi”, kl.12 - 36 orë**

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme mbi topogjeodezinë	3 orë
<b>Tema 2</b>	Njohuri mbi hartat topografike	7 orë
<b>Tema 3</b>	Matja e këndeve	6 orë
<b>Tema 4</b>	Matja e largësive	3 orë

<b>Tema 5</b>	Matja e sipërfaqeve	3 orë
<b>Tema 6</b>	Pozicioni në plan i sipërfaqes së tokës	4 orë
<b>Tema 7</b>	Pozicioni në lartësi i pikave të sipërfaqeve të tokës	6 orë
<b>Tema 8</b>	Relevimi takeometrik	4 orë

#### 4. Lënda “Bazat e lultarisë” (L-25-335-13) Kl. 12 – 72 orë

- **Synimet e lëndës ”Bazat e lultarisë“ kl 12**

Në përfundim të lëndës “Bazat e lultarisë” kl 12 nxënësit duhet :

- Të shpjegojnë mënyrat e shumëzimit të luleve
- Të përshkruajnë shumëzimin me farë
- Të përshkruajnë mbjelljen e farës në fushë të hapur
- Të dallojnë mbjelljet në shtretër dhe sera
- Të përshkruajnë shumëzimin vegjetativ
- Të klasifikojnë mjetet dhe veglat e punës që përdoren në lultari
- Të përshkruajnë shërbimet kulturale që kryhen në lultari
- Të dallojnë shërbimet që kryhen para mbirjes
- Të argumentojnë trapiantimin si proces i domosdoshëm te lulet
- Të përlllogarisin nevojat e bimës për ujë
- Të planifikojnë kohën e kryerjes së prashitjeve
- Të shpjegojnë sektorët e prodhimit të luleve
- Të përshkruajnë mjediset e mbrojtura
- Të ndertojnë kalendarin e punës në lultari
- Të shpjegojnë qarkullimet bujqësore në kopshtari
- Të përlllogarisin koston kulturale në lultari

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e lultarisë” Kl. 12 – 72 orë.**

<b>Tema 1</b>	Shumimi i bimëve, shumimi me farë	2 orë
<b>Tema 2</b>	Mbjellja e farës në fushë të hapur, shtretër e sera	6 orë
<b>Tema 3</b>	Shumëzimi vegjetativ	8 orë
<b>Tema 4</b>	Mjetet dhe veglat e punës	4 orë
<b>Tema 5</b>	Shërbimet kulturale	8 orë
<b>Tema 6</b>	Tranpantimi, ujitja e prashitja	20 orë
<b>Tema 7</b>	Sektorët e prodhimit në fushë të hapur	6 orë
<b>Tema 8</b>	Mjediset e mbrojtura	10 orë
<b>Tema 9</b>	Kalendari i punimeve	4 orë
<b>Tema 10</b>	Qarkullimet bujqësore në kopshtari	2 orë
<b>Tema 11</b>	Përbërja dhe rëndësia e koston kulturale	2 orë

#### 5. Lënda “Ekologjia e luleve” (L-25-336-13 ) Kl. 12 – 36 orë

- **Synimet e lëndës ”Ekologjia e luleve“ kl 12**

Në përfundim të lëndës “Ekologjia e luleve” kl 12 nxënësit duhet :

- Të përshkruajnë objektin e lëndës Ekologjia e luleve

- Të shpjegojnë kërkesat e luleve për temperature
- Te shpjegojnë ndikimet që sjellin ndryshimet e temperaturave në lule .
- Të përcaktojnë kërkesat e luleve për temperaturë
- Të klasifikojnë bimët sipas kërkesave që kanë për lagështi dhe ujë.
- Të argumentojnë nevojat e ndryshme për dritë të luleve
- Të përshkruajnë tokat që kërkojnë lulet.
- Të përshkruajnë përbërjen e dherishtes
- Të shpjegojnë efektin e plehrave organikë që përdorin te lulet
- Të argumentojnë rolin e NPK
- Të shpjegojnë rolin e mikroelementeve

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ekologjia e luleve” Kl. 12 – 36 orë.**

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme.Objekti i ekologjisë	4 orë
<b>Tema 2</b>	Klima, mjedisi atmosferik	6 orë
<b>Tema 3</b>	Fenologjia	2 orë
<b>Tema 4</b>	Toka, përbërja fizike e kimike	8 orë
<b>Tema 5</b>	Lagështia dhe uji	4 orë
<b>Tema 6</b>	Dherishtja	2 orë
<b>Tema 7</b>	Plehu, llojet që përdoren	4 orë
<b>Tema 8</b>	Plehrat kimikë, NPK	4 orë
<b>Tema 9</b>	Mikroplehrat	2 orë

**6. Lënda “Lulet një dhe dy vjeçare” (L-25-337-13) Kl. 12 – 72 orë**

• **Synimet e lëndës ”Lulet një dhe dy vjeçare“kl 12**

Në përfundim të lëndës “Lulet një dhe dy vjeçare” kl 12 nxënësit duhet :

- Të përshkruajnë objektin e lëndës lulet një e dy vjeçare
- Të shpjegojnë mënyrat e shumëzimit të tyre
- Të përshkruajnë ciklin e tyre jetsorë
- Të përshkruajnë ndërtimin e tyre botanik
- Të shpjegojnë kohën e lulzimit të tyre
- Të shpjegojnë afatet e mbjelljes së tyre
- Të shpjegojnë shërbimet që i kryhen luleve një dhe dy vjeçare
- Të shpjegojnë arsyet e një shërbimi të shpejtë
- Të ndërtojnë një mozaik kulture
- Të përshkruajnë kulturat ujore

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Lulet një dhe dy vjeçare” Kl. 12 – 72 orë.**

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme, objekti i lultarisë	4 orë
<b>Tema 2</b>	Vecori të luleve një dhe dy vjeçare	10 orë
<b>Tema 3</b>	Bimë me lulzim pranveror	6 orë
<b>Tema 4</b>	Bimë me lulzim pranverë -verë	6 orë
<b>Tema 5</b>	Bimë me lulzim veror	4 orë
<b>Tema 6</b>	Bime zbukuruese me lulzim pranverë-verë-vjeshtë	20 orë
<b>Tema 7</b>	Bime zbukuruese me lulzim verë-vjeshtë	8 orë

<b>Tema 8</b>	Mozaik kultura	8 orë
<b>Tema 9</b>	Bimët një vjecare dhe dy vjeçare ujore	6 orë

### 7. Lënda “Bimët mjeksore ” (L-25-338-13) Kl. 12 – 36 orë

- **Synimet e lëndës ”Bimët mjeksore “ kl 12**

Në përfundim të lëndës “Bimët mjeksore ” kl 12 nxënësit duhet :

- Të shpjegojnë vlerat e bimëve mjeksore.
- Të përcaktojnë rregullat e mbledhjeve të bimëve mjeksore .
- Të përcaktojnë mënyrat e tharjes të bimëve mjeksore .
- Të rendisin bimët mjeksore një dhe dy vjecare .
- Të rendisin bimët mjeksore shumëvjecare.
- Të përcaktojnë mënyrat e përdorimit të bimëve mjeksore

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bimët mjeksore ” Kl. 12 – 36 orë.**

<b>Tema 1</b>	Njohja dhe rëndësia e bimëve mjeksore	1 orë
<b>Tema 2</b>	Mbledhja dhe ruajtja e bimëve mjeksore	3 orë
<b>Tema 3</b>	Bimët mjeksore një dhe dy vjecare	12 orë
<b>Tema 4</b>	Bimët mjeksore shumëvjecare	17 orë
<b>Tema 5</b>	Mënyrat e përdorimit të bimëve mjeksore	3 orë

### 8. Lënda “Bimët aromatike dhe eterovajore” (L-25-339-13) Kl. 13 – 32 orë

- **Synimet e lëndës ”Bimët aromatike dhe eterovajore“ kl 13**

Në përfundim të lëndës “Bimët aromatike dhe eterovajore” kl 13 nxënësit duhet :

- Të shpjegojnë rëndësinë ekonomike të bimëve aromatike dhe eterovajore
- Të shpjegojnë mundësitë e përhapjes në vendin tonë të bimëve aromatike dhe eterovajore
- Të shpjegojnë rëndësinë e borzilokut dhe vecoritë botanike
- Të shpjegojnë teknologjinë e kultivimit të borzilokut
- Të shpjegojnë rëndësinë e lavandulës dhe vecoritë e saj
- Të shpjegojnë teknologjinë e kultivimit të lavandulës
- Të shpjegojnë rëndësinë e timusit dhe vecoritë botanike
- Të argumentojnë teknologjinë që përdoret te timusi
- Të shpjegojnë rëndësinë e piretrumit dhe vecoritë e saj
- Të argumentojnë teknologjinë e kultivimit të piretrumit
- Të shpjegojnë rëndësinë e sherebeles
- Të argumentojnë shtrirjen e sherebeles në zona më të gjëra
- Të shpjegojnë përbërjen kimike të bimëve aromatike
- Të shpjegojnë vjeljen e bimëve aromatike
- Të argumentojnë mënyra të ndryshme të përpunimit të tyre
- Të shpjegojnë mënyrat e magazinimit.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bimët aromatike dhe eterovajore” Kl. 13 – 32 orë.**

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme, rëndësia ekonomike dhe mundësitë e përhapjes të tyre	4 orë
<b>Tema 2</b>	Borziloku, vecoritë, kultivimi	3 orë
<b>Tema 3</b>	Lavandola, vecorite, teknologjia e kultivimit	3 orë
<b>Tema 4</b>	Timusi, vecoritë, teknologjia e kultivimit	3 orë
<b>Tema 5</b>	Piretrumi, vecoritë, teknologjia e kultivimit	3 orë
<b>Tema 6</b>	Sherebela, vecorite, teknologjia e kultivimit	4 orë
<b>Tema 7</b>	Përbërja kimike e bimëve aromatike	2 orë
<b>Tema 8</b>	Vjelja, përpunimi, magazinimi	10 orë

### **9. Lënda “Drurët dhe shkurret dekorative” (L-25-340-13) Kl. 13 – 64 orë**

- **Synimet e lëndës ”Drurët dhe shkurret dekorative“ kl 13**

Në përfundim të lëndës “Drurët dhe shkurret dekorative” kl 13 nxënësit duhet :

- Të shpjegojnë rolin e kopshtit botanik
- Të dallojnë bimët shkurre
- Të përshkruajnë llojet gjethërenëse nga ato jogjethërenëse
- Të përshkruajnë llojet kacavjerrëse
- Të përshkruajnë artisjen e drurëve të rritur
- Të shpjegojnë qëllimin e kultivimit të bimëve dekorative në rrugë
- Të përllogarisin normat e gjelbërimit
- Të dallojnë qilimet e gjelbra
- Të ndërtojnë qilime të gjelbra
- Të përshkruajnë vecoritë e luleve në ballkone
- Të njohin parimet e krasitjes
- Të bëjnë krasitjen e drurëve të ndryshëm.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Drurët dhe shkurret dekorative” Kl. 13 – 64 orë.**

<b>Tema 1</b>	Kopshtet botanike dhe roli i tyre	2 orë
<b>Tema 2</b>	Bimë barishtore e shkurre për zbukurim	2 orë
<b>Tema 3</b>	Drurë e shkurre gjethërenëse për lule	4 orë
<b>Tema 4</b>	Shkurre gjethërenëse për lule	10 orë
<b>Tema 5</b>	Shkurre kacavjerrëse për gjethin	3 orë
<b>Tema 6</b>	Shkurre përherë të blerta	5 orë
<b>Tema 7</b>	Shkurre gjethërenëse kacavjerrëse për lule	4 orë
<b>Tema 8</b>	Shkurre përherë të blerta kacavjerrëse për lule	3 orë
<b>Tema 9</b>	Shkurre gjithmonë të gjelbra	4 orë
<b>Tema 10</b>	Artisja e drurëve	4 orë
<b>Tema 11</b>	Mbjellja në rrugë, normat e gjelbërimit	2 orë
<b>Tema 12</b>	Qilimat e gjelbërt	5 orë
<b>Tema 13</b>	Shkurre të përherëshme për lule	4 orë

<b>Tema 14</b>	Drurë përherë të blertë	5 orë
<b>Tema 15</b>	Shkurre për tarraca e ballkone	2 orë
<b>Tema 16</b>	Krasitja, parime të përgjithshme	5 orë

### 10. Lënda “Lulet shumëvjeçare” (L-25-341-13) Kl 13- 64 orë

- **Synimet e lëndës ”Lulet shumëvjeçare“ kl 13**

Në përfundim të lëndës “Lulet shumëvjeçare” kl 13 nxënësit duhet;

- Të shpjegojnë mënyrat e shumzimit të luleve shumëvjeçare
- Të organizojnë teknikën e mbjelljes së luleve shumëvjeçare
- Të njohin lulet kacavjerrëse
- Të dallojnë lulet shumëvjeçare për lule të prera
- Të dallojnë lulet shumëvjeçare ujore
- Të njohin vlerat e luleve qepore
- Të dallojnë bimët qepore nga zhardhokore dhe rizomatoze
- Të argumentojnë kultivimin e bimëve në apartamente
- Të shpjegojnë ndërtimin e luleve mishtore
- Të përcaktojnë bimët sukulente
- Të përshkruajnë sforcimin e bimëve zbukuruese
- Të kryejnë harmonizimin e ngjyrave të luleve

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Lulet shumëvjeçare” Kl. 13 – 64 orë**

<b>Tema 1</b>	Mënyrat e shumimit, teknikat e mbjelljes	2 orë
<b>Tema 2</b>	Bimët barishtore kacavjerrëse me lulëzim verë-vjeshtë	4 orë
<b>Tema 3</b>	Bimët shumëvjeçare për lule	8 orë
<b>Tema 4</b>	Bimët shumëvjeçare ujore për lule	2 orë
<b>Tema 5</b>	Bimë tipike serash me lulëzim pranveror- veror	4 orë
<b>Tema 6</b>	Bimët qepore, zhardhokore e rizomatoze	12 orë
<b>Tema 7</b>	Bimët për apartamente	7 orë
<b>Tema 8</b>	Bimët për lule të prera	8 orë
<b>Tema 9</b>	Bimë të mishta sukulente	4 orë
<b>Tema 10</b>	Trëndafilat dhe kultivimi	8 orë
<b>Tema 11</b>	Sforcimi i bimëve zbukuruese	3 orë
<b>Tema 12</b>	Harmonizimi i ngjyrave të luleve	2 orë

### 11. Lënda “ Mbrojtja e luleve nga sëmundjet dhe dëmtuesit” (L-25-342-13) Kl.13 – 32 orë

- **Synimet e lëndës ”Mbrojtja e luleve nga sëmundjet dhe dëmtuesit “ kl 13**

Në përfundim të lëndës “Mbrojtja e luleve nga sëmundjet dhe dëmtuesit “ kl 13 nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë objektin e lëndës “Mbrojtja e luleve nga sëmundjet dhe dëmtuesit”



- Të përshkruajnë insektet që dëmtojnë lulet
- Të përshkruajnë sëmundjet e përbashkëta të luleve
- Të përshkruajnë dëmtuesit polifagë
- Të shpjegojnë dëmtuesit e luleve qepore
- Të shpjegojnë dëmet e brejtësve
- Të përshkruajnë sëmundjet tek trëndafilet
- Të përcaktojnë dëmet nga dëmtuesit tek trëndafili
- Të përshkruajnë dëmtuesit tek shpatorja
- Të argumentojnë masat e luftimit tek dëmtuesit dhe sëmundjet
- Të shpjegojnë metodat kimike për të luftuar dëmtuesit
- të shpjegojnë metodat kimike dhe preparatet për të luftuar sëmundjet
- Të shpjegojnë mënyrat e përgatitjes së preparateve kimike
- Të shpjegojnë dëmet që sjellin barërat e këqija

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mbrojtja e luleve nga sëmundjet dhe dëmtuesit “ kl 13- 32 orë**

<b>Tema 1</b>	Objekti e rëndësia e mbrojtjes së luleve	2 orë
<b>Tema 2</b>	Njohuri mbi insektet dëmtues	5 orë
<b>Tema 3</b>	Dëmtues dhe sëmundje të përbashkëta polifage	6 orë
<b>Tema 4</b>	Dëmtues të luleve , tulipanit gladiolës	4 orë
<b>Tema 5</b>	Brenjtësit	2 orë
<b>Tema 6</b>	Dëmtuesit e sëmundjes së trendafilut	2 orë
<b>Tema 7</b>	Sëmundjet e dëmtues të shpatores	2 orë
<b>Tema 8</b>	Masat e luftimit	3 orë
<b>Tema 9</b>	Metodat kimike	3 orë
<b>Tema 10</b>	Barërat e këqija	3 orë

## **12. Lënda “Mbrojtja e natyrës dhe planifikimi i teritorit” (L-25-234-11) Kl. 13 – 32 orë**

- **Synimet e lëndës ” Mbrojtja e natyrës dhe planifikimi i teritorit”, kl -13**

Në përfundim të lëndës “ Mbrojtja e natyrës dhe planifikimi i teritorit” kl.13 nxenesit duhet:

- Të shpjegojnë qëllimin e objektivat e mbrojtjes mjedisore .
- Të shpjegojnë formatet e ndryshme të përdorimit të tokës.
- Të shpjegojnë punën që duhet bërë për mbrojtjen e jetës së egër.
- Të shpjegojnë rëndësinë e planifikimit të teritorit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e planifikimit dhe implementimit të teritorit dhe mbrojtjen e natyrës.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mbrojtja e natyrës dhe planifikimi i teritorit” Kl. 13– 32 orë.**

<b>Tema 1</b>	Objekti , rëndësia e mbrojtjes së mjedisit e plabnifikimit të teritorit.	4 orë
<b>Tema 2</b>	Mbrojtja e natyrës dhe përdorimi i tokës .	5 orë
<b>Tema 3</b>	Zonat e banuara dhe minierat e hapura	3 orë

<b>Tema 4</b>	Mbrojtja e llojeve dhe ruajtja e jetës së egër .	7 orë
<b>Tema 5</b>	Estetika e teritorit dhe mbrojtja e mjedisit	3 orë
<b>Tema 6</b>	Qëllimi dhe objektivat e planifikimit të teritorit	3 orë
<b>Tema 7</b>	Detyrat e planifikimit të teritorit	4 orë
<b>Tema 8</b>	Njerëzit, autoritetet dhe institucionet që merren me planifikimin e teritorit	2 orë

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli “Punimet për ngritjen e lulishtes”

Drejtimi: Pyje  
Profili: Florikulturë  
Niveli: III  
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT	
Titulli dhe kodi	PUNIMET PËR NGRITJEN E LULISHTES M-25-967-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për ngritjen e lulishtes
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi ndërton skemën e lulishtes dhe zgjedh drurët</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Analiza e hartës topografike</li><li>– Përcaktimi i drurëve dekorativë</li><li>– Përcaktimi i sipërfaqes që do zënë drurët</li><li>– Përcaktimi i sipërfaqes së qilimit të blertë</li><li>– Përcaktimi i luleve që do mbillen</li><li>– Përcaktimi i farave të barit që do mbjellin</li><li>– Skicimi i elementëve të ndërtimit</li><li>– Vendosja për stilin që do aplikohet</li><li>– Vendosja për mënyrat e ujitjes</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së vendit të punës.</li><li>– <b>Instrumentet e vlerësimit:</b></li><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të analizojë hartën topografike</li><li>– të përcaktojë drurët dekorativë</li><li>– të përcaktojë sipërfaqen që do zënë drurët</li><li>– të përcaktojë sipërfaqën e qilimit të blertë</li><li>– të përcaktojë lulet që do mbillen</li><li>– të përcaktojë farën e barit që do mbjellin</li><li>– të përcaktojë elementet e ndërtimit</li><li>– të zgjedhë stilin që do aplikohet</li></ul>

- 
- të përcaktojë mënyrën e ujitjes
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së vendit të punës
- 

## **RM 2 Nxënësi ndërton veprat e artit.**

### ***Përmbajtja:***

- Ndërtimi i veprave e artit
- Vendosja e shesheve të lodrave për fëmijë
- Vendosja e lodrave sportive
- Ndërtimi i rrjetit rrugor
- Vendosja e stolave për pushime
- Vendosja e sistemit të ndricimit
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimit të veprave të artit

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndërtojë veprat e artit
- të vendosë sheshet e lodrave për fëmijë
- të vendosë lodrat sportive
- të ndërtojë rrjetin rrugor
- të vendosë stolat për pushime
- të vendosë sistemin e ndricimit
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kubimit të drurit në këmbë.

## **RM 3 Nxënësi kryen punimet bazë për ngritjen e lulishtes**

### ***Përmbajtja:***

- Zgjedhja e vendit të vendosjes së shesheve të lodrave
- Hapja e gropave të mbjelljes së drurëve
- Përgatitja e drurëve për mbjellje
- Mbjellja e drurëve dekorativë
- Përgatitja e tokës për mbjelljen e farës, barit
- Shpërndarja e farës së barit
- Ngjeshja e farës
- Mbjellja e luleve
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve bazë

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zgjedhë vendin e sheshit të lodrave
- të hapë gropat për mbjelljen e drurëve dekorativë
- të përgatisë fidanat për mbjellje
- të përgatisë tokën për mbjelljen e farës së barit
- të bëjë shpërndarjen e farës së barit

- të bëjë ngjeshjen e farës së barit
- të bëjë mbjelljen e luleve
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve bazë

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në lulishtet publike .
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të punimeve për ngritjen e lulishtes, të njohë drurët zbukurues, që mbillen në zonën tonë, të njohë lulet që kultivohen, të njohë elementet e artit .
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore , përcaktimin e sipërfaqeve të lulishteve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në përgatitjen skemave të mbjelljeve, lodrave të ndryshme për fëmijë, lodrave sportive, për rrjetin rrugor.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe paisjeve..
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e ndërtimit të lulishteve.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Sipërfaqe e lulishteve publike
  - Mjete pune te ndryshme
  - Komplete veshje e puntorit ne fushen e lulishteve
  - Harta dhe busull orjentuese.
  - Makine llogaritëse , kanceleri te ndryshme etj
  - Fidana, lule, fara bari,
  - Lodra për fëmijë, lodra sportive, stola, sistem ndricimi.
-

## 2. Moduli “Kultivimi i luleve në shtretër e sera”

Drejtimi: Pyje

Profili: Florikulturë

Niveli: III

Klasa: 12

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KULTIVIMI I LULEVE NE SHTRETER E SERA	M-25-968-13
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kultivuar lule në shtretër e sera	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi përgatit shtretërit e nxehtë.</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Ndërtimi i planimetrisë së shtretërve</li><li>– Zgjedhja e shtratit që do ndërtohet</li><li>– Planifikimi i materialeve që duhen</li><li>– Grumbullimi i materialit</li><li>– Hapja e gropave për ndërtimin e shtratit</li><li>– Vendosija e mureve anësore</li><li>– Mbushja e shtratit</li><li>– Zgjedhja e materialit ngrohës</li><li>– Vendosija e dherishtes</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të ndërtojë planimetrinë e shtretërve</li><li>– të zgjedhë tipin e shtratit</li><li>– të planifikojë materialet që duhen</li><li>– të grumbullojë materialet</li><li>– të hapë gropën për ndërtimin e shtratit</li><li>– të vendosë muret anësore</li><li>– të bëjë mbushjen e shtratit</li><li>– të zgjedhë tipin e ngrohjes</li><li>– të vendosë dherishten</li><li>– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit</li></ul>	

## **RM 2 Nxënësi bën mbjelljen e shtratit**

### ***Përmbajtja:***

- Përcaktimi i afateve të mbjelljes
- Njomja dhe parambirja
- Shtratifikimi i farërave
- Pastrimi i farërave
- Përcaktimi i thellësisë së mbjelljes farërave
- Mbjellja e farës
- Mbjellja e copave për kalitje
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë afatet e mbjelljes
- të njomë farërat
- të shtratifikojë farën
- të bëjë pastrimin e farërave
- të përcaktojë thellësinë e mbjelljes
- të mbjellë farën
- të mbjellë copat për kalitje
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

## **RM 3 Nxënësi kryen shërbime pas mbjelljes**

### ***Përmbajtja:***

- Rregullimi i temperaturës në shtrat
- Hijëzimi i shtratit të nxehtë
- Ujitja e bimëve
- Plehrimi i bimëve
- Luftimi i sëmundjeve
- Kalitja e fidanave
- Ndërrimi i fidanave
- Shkulja e fidanave
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të rregullojë temperaturën në shtratin e nxehtë
- të bëjë hijëzimin
- të kryejë ujitjet e bimëve
- të bëjë plehrimin e bimëve
- të luftojë sëmundjet
- të kalisë fidanat

- të bëjë ndërrimin e fidanave
- të shkulë fidanat
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

#### **RM 4 Nxënësi bën kultivim e luleve në sera të thjeshta .**

##### ***Përmbajtja:***

- Ndërtimi i planimetrisë
- Zgjedhja e vendit
- Ndërtimi i konstruksionit të jashtëm
- Ndërtimi i catisë
- Pajisja e brendshme
- Ngrohja e serës
- Rregullimi i ujitjes
- Sistemi i ajrosjes
- Dezenfektimet në serë
- Punimi i tokës
- Plehrimi i tokës
- Mbjellja e farës
- Shërbimet para mbirjes
- Shërbimet pas mbirjes
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndërtojë planimetrinë e serës
- të zgjedhë vendin
- të ndërtojë konstruksionin e serës
- të ndërtojë mbulesën e serës
- të ndërtojë pajisjet e brendshme
- të ngrohë serën
- të rregullojë ujitjen
- të bëjë ajrosjen
- të bëjë dezenfektimin
- të bëjë punimin e tokës
- të plehrojë tokën
- të mbjellë farën
- të bëjë shërbimet para mbirjes
- të bëjë shërbimet pas mbirjes
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit



---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesionalë

- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete.
- Nxënësit duhet të angazhohen me veprimtari konkrete pune. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e punimeve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset e punës, materialet e ndryshme dhe veglat si më poshtë:

- Shtretër të nxehtë, sera të thjeshta, vegla pune, mjete spërkatëse, plehra, farëra, skica të shtretërve, makete.

---

### 3. Moduli “Përgatitja e kalemave për mbjellje”

Drejtimi: Pyje  
Profili: Florikulturë  
Niveli: III  
Klasa: 12

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PERGATITJA E KALEMAVE PER MBJELLJE	M-25-969-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për përgatitjen e kalemave për mbjellje	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi zgjedh kalemat.</b> <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Zgjedhja e bimëve mëmë</li><li>– Zgjedhja e llojeve</li><li>– Përcaktimi i përmasave të kalemave</li><li>– Prerja e copave për nënshartesë</li><li>– Prerja e copave për mbishartesa</li><li>– Përgatitja e shpatullave</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të zgjedhë bimët mëmë</li><li>– të zgjedhë llojet</li><li>– të përcaktojë masat e kalemave</li><li>– të presë copat për nën shartesë</li><li>– të presë copat për mbi shartesë</li><li>– të përgatitë shpatullat</li><li>– Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi shtratifikon kalemat.</b> <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vendosja në shtrat e kalemave</li><li>– Mbulimi me rërë</li><li>– Vendosja në banjëzim</li><li>– Vendosja në arka të ftohta</li></ul>	

- Vendosja në vazo lulesh
- Përgatitja e rërës
- Rregullimi i temperaturës
- Rregullimi i lagështirës
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vendosë kalemata në shtrat
- të mbulojë kalemata me rërë
- të bëjë banjëzim
- të vendosë në arka të ftohta
- të vendosë në vazo lulesh
- të përgatisë rërën
- të rregullojë temperaturat
- të rregullojë lagështirën
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë shtratifikimit të kalemave

**RM 3 Nxënësit bën mbjelljen e kalemave**

***Përmbajtja:***

- Punimi i tokës
- Përcaktimi i distancave të rreshtave
- Vendosja e copave
- Rrënjëzimi
- Mirëmbajtja e copave
- Ruajtja në lokale
- Përgatitja e copave me kokë
- Përgatitja e copave me thunder
- Përgatitja e copave me një syth
- Copa brenda në ujë
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të punojë tokën
- të përcaktojë distancat e rreshtave
- të vendosë copat
- të bëjë rrënjëzim
- të mirëmbajë copat
- të ruajë në lokale
- të përgatisë copat me kokë
- të përgatisë copat me thundër
- të përgatisë copat me një syth

- të përgatisë copat në ujë
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit .

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesionalë në parcelën e shkollës dhe fidanishte
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete për të përgatitë copa për mbjellje
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer procese pune në trajtimet e kalemave dhe përgatitjen e tyre për mbjellje.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës .
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në përgatitjen e kalemave për rrënjëzimin e tyre dhe sigurimin e mbjelljeve të mira.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat dhe materialet e mëposhtme:
- Fidanishte e shkollës, lulishtet publike, kalema.
  - Komplete veglash dhe veshjesh për të punuar në mjediset publike.
  - Katalogë dhe manuale.
-

#### 4. Moduli “Përdorimi i preparateve kimikë”

Drejtimi: Pyje  
Profili: Florikulturë  
Niveli: III  
Klasa: 12

##### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PERDORIMI I PREPARATEVE KIMIKE	M-25-970-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për përdorimin e preparateve kimikë	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi zgjedh mënyrën e përdorimit të preparatit</b> <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Zgjedhja e veglave të punës</li><li>– Spërkatja</li><li>– Pluhurosja</li><li>– Banjëzimi</li><li>– Tymosja</li><li>– Dezinfektimi</li><li>– Koha e kryerjes</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë trajtimeve kimike.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të bëjë spërkatje</li><li>– të pluhurosë</li><li>– të bëjë banjëzimin</li><li>– të tymosë</li><li>– të bëjë dezinfektimin</li><li>– të gjejë kohën e kryerjes së tyre</li><li>– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë trajtimeve kimike</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi mbrohet nga helmet</b> <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Përcaktimi i mjeteve të punës</li><li>– Ndhimja e parë nga helmimet</li></ul>	

- Masat gjatë ruajtjes së preparatit
- Karantina
- Prognos sianjalizimi
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të zgjedhë mjetet e punës
- të japë ndihmën e parë
- të njohë masat për ruajtje
- të dijë të vendosë karantinë
- të vendosë prognose sinjalizimin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në dhe ato të mbrojtjes së mjedisit gjatë damkosjes së drurit

**RM 3 Nxënësi lufton sëmundjet dhe dëmtuesit.**

***Përmbajtja:***

- Përcaktimi i preparatit
- Përgatitja e përzierjeve
- Përcaktimi i përqëndrimit
- Verifikimi i reaksionit
- Përgatitja e veglave për spërkatje
- Veshja e robave, dorezave e syzeve
- Kryerja e spërkatjes
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojë preparatin për spërkatje
- të përgatisë përzierjen
- të përcaktojë përqëndrimin
- të verifikojë reaksionin
- të përgatisë veglat
- të veshë robat, dorezat dhe syzet
- të kryejë spërkatje
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në parcelën e shkollës dhe në lulishtet publike.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të spërkatjes, pluhrosjes, tymosjes, dhe dezinfektimit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për

---

kryerjen e veprimeve përgatitore , kryerjen e trajtimeve kimike, dhënien e ndihmës nga helmimet, venien e karantinës dhe të prognosë sinjalizimit.

- Nxënësit duhet të angazhohen në përgatitjen e përzierjeve të preparateve kimikë.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe paisjeve..
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e përdorimit të trajtimeve kimikë.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- Sipërfaqe me lule dhe bime dekorative.
- Mjete pune te ndryshme
- Komplete veshje e puntorit të përkatjeve
- Pompë spërkatjeje, pluhrosjeje, tymosjeje, preparate kimikë, rroba, doreza, syze.

---

## 5. Moduli “Shartimet”

Drejtimi: Pyje  
Profili: Florikulturë  
Niveli: III  
Klasa: 12

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SHARTIMET	M-25-971-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit të mësojë të kryejë shartimet	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi bën shartimin me kalem (copa të drunjëzuara).</b> <b>Përmbajtja</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Zgjedhja e bimëve mëmë</li><li>– Zgjedhja e mbishartesave</li><li>– Zgjedhja e kalemave</li><li>– Përcaktimi i nënshartesave</li><li>– Përgatitja e veglave për shartim</li><li>– Përgatitja e lëndës mbushëse</li><li>– Vendosja e mënyrës së vënies së kalemave</li><li>– Çarja e nënshartesës</li><li>– Përgatitja e mbishartesës</li><li>– Vendosja e mbishartesës</li><li>– Lidhja e shartimit</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të zgjedhë bimët mëmë</li><li>– të zgjedhë mbishartesat</li><li>– të zgjedhë kalemat</li><li>– të përcaktojë nënshartesën</li><li>– të përzgjedhë veglat për shartim</li><li>– të përgatisë lëndën mbushëse</li><li>– të vendosë mënyra e vënies së kalemave</li><li>– të bëjë çarjen e nënshartesës</li><li>– të përgatitë mbishartesa</li></ul>	



- 
- të vendosë mbishartesa
  - të bëjë lidhjen e shartimit
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

## **RM 2 Nxënësi bën shartimin me copa të gjelbra**

### ***Përmbajtja***

- Përcaktimi i kohës së shartimit
- Zgjedhja e vendit të shartimit të nënshartesës
- Zgjedhja e mbishartesës
- Përgatitja e veglavë të mbishartimit
- Prerja e nënshartesës
- Prerja e lëvores në formë T
- Prerja e sythit të mbishartesës
- Heqja e sythit
- Vendosja e sythit të nënshartesës
- Lidhja e sythit
- Shartimi me syth të fjetur
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të zgjedhë vendin të shartimit
- të zgjedhë mbishartesën
- të përgatitë veglat e shartimit
- të bëjë prerjen e nënshartesës
- të presë lëvoren në formë T
- të presë sythin të mbishartesës
- të heqë sythin
- të vendosë sythin të nënshartesës
- të lidhë sythet
- të dallojë shartimin me syth të zgjuar dhe të fjetur
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

## **RM 3 Nxënësi bën shartime tjera**

### ***Përmbajtja***

- Shartimi me gjuhëz ose kopulim
- Shartimi me afrim
- Shartimi me prerje së gjati
- Shartimi anësor
- Shartimi me unazë
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës për luftimin e sëmundjeve në fidanishte.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të bëjë shartimin me gjuhëz
- të bëjë shartimin me afrim
- të bëjë shartimin me prerje së gjati
- të bëjë shartimin anësor
- të bëjë shartimin me unazë
- të zbatoje rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional në fidanishtet pyjore e të luleve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë te jete e mundur demonstrime konkrete për të bërë shartime me copa të drunjëzuara dhe me copa të gjelbra
- Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete pune për të kryer shartime tek lulet dhe bimët dekorative
- Ata duhet të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për të shartuar lulet dhe fidanat e ndryshëm, të njohin sa më shumë lloje shartimit dhe kohën në të cilën kryhen.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet ti vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes të shprehive praktike për realizimin e proceseve për të shartuar bimë të ndryshme.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mesuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise te praktikes per te shartuar fidana dhe lule
  - Komplet i veglave, veshjet, paisjet dhe materialet e nevojshme per te kryer shartime te ndryshme.
  - Katalogje, manuale udhezues etj.
-

## 6. Moduli “Përgatitja e dherishtes”

Drejtimi: Pyje  
Profili: Florikulturë  
Niveli: III  
Klasa: 12

### PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PERGATITJA E DHERISHTES	M-25-972-13
Qëllimi i modulit	Nje modul qe afteson nxenesit per te përgatitur dherishte.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi përgatit dheun.</b> <b>Përmbajtja</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Përcaktimi i sasisë së dheut që duhet</li><li>– Zgjedhja e veglave të punës</li><li>– Zgjedhja e vendit ku duhet të merret dheu</li><li>– Marrja e dheut</li><li>– Vendosja e dheut në formë piramide</li><li>– Dezinfektimi i dheut</li><li>– Grirja e dheut</li><li>– Sitja e dheut</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të përcaktojë sasinë e dheut</li><li>– të bëjë zgjedhjen e dheut</li><li>– të zgjedhë veglat e punës</li><li>– të vendosë dheun në formë piramidale</li><li>– të thërmojë dheun</li><li>– të dezinfektojë dheun</li><li>– të bëjë sitjen e dheut</li><li>– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit</li></ul>	

## **RM 2 Nxënësi përgatit plehun**

### ***Përmbajtja***

- Zgjedhja e veglave të punës
- Zgjedhja e plehut që do përdoret
- Vendosja e plehut kavaletë
- Dezinfektimi i plehut
- Nxjerrja e plehut nga kavaleta
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të zgjedhë veglat e punës
- të zgjedhë llojin e plehut
- të vendosë plehun në kavalete
- të bëjë dezinfektimin e plehut
- të nxjerrë plehun nga kavaleta
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

## **RM 3 Nxënësi përgatit dherishten.**

### ***Përmbajtja***

- Përcaktimi i përbërësve të dherishtes
- Sigurimi i rërës
- Sigurimi i torfës
- Përzierja e pjesëve përbërëse
- Pasurimi i dherishtes
- Dizenfektimi i dherishtes
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përcaktojë përbërësit
- të sigurojë rërën
- të sigurojë torfën
- të përziejë pjesët përbërëse
- të bëjë pasurimin e dherishtes
- të dezinfektojë dherishten
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

---

### **Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise për praktikantë profesionale në parcelën pranë shkollës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë demonstrimet konkrete në proceset e punës për përgatitjen e

---

dherishtes.

- Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete për zgjedhjen e dheut , të plehut, të torfës, të vendosjes në formë kavaleti, të bëjë dezinfektimin.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për ndërtimin e dherishtes. Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të verifikohet shkalla e arritjes së shprehive praktike për realizimin e përgatitjes së dherishtes.
- Realizimi i pranueshem i modulit do të konsiderohet arritja e kenaqshme e te gjitha kriterëve te realizimit te specifikuar per cdo rezultat te te mesuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme te sigurohen mjediset, veglat, paisjet dhe materialet e meposhtme:

- Dhe, pleh organik, torfë, rërë
  - Vegla te thjeshta dore, si kazma, bel, shate, krehera etj
  - Prehra te ndryshem
  - Uniforma e punes
  - Kataloge, manuale te ndryshme.
-

## 7. Moduli “Shumëzimi dhe mbjellja e shkurreve dekorativë”

Drejtimi: Pyje  
Profili: Florikulturë  
Niveli: III  
Klasa: 12

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SHUMEZIMI DHE MBJELLJA E SHKURREVE DEKORATIVE	M-25-973-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për shumëzimin dhe mbjelljen e shkurreve dekorative	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi bën shumëzimin me farë</b> <b>Përmbajtja</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Zgjedhja e bimëve mëmë</li><li>– Zgjedhja e farës</li><li>– Pastrimi i farës</li><li>– Ruajtja e farës</li><li>– Parambirja</li><li>– Mbjellja e farës</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të zgjedhë bimët mëmë</li><li>– të zgjedhë farën</li><li>– të bëjë pastrimin e farës</li><li>– të ruajë farën</li><li>– të bëjë parambirjen</li><li>– të mbjellë farën</li><li>– të zbatojë masat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë inventarizimit të kulturave uniforme</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi bën shumëzimin vegjetativ</b> <b>Përmbajtja</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Zgjedhja e bimëve mëmë</li><li>– Zgjedhja e copave</li><li>– Zgjedhja e copave rrënjore</li></ul>	

- Zgjedhja e gjetheve
- Shumëzimi me ndarje
- Shumëzimi me rizomë
- Vendosja në kushte mbirjeje
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të zgjedhë bimët mëmë
- të zgjedhë copat
- të zgjedhë copat rrënjore
- të zgjedhë gjethet
- të dijë të bëjë shumëzimin me ndarje
- të bëjë shumëzimin me rizomë
- ti vejë në kushte mbirjeje
- të zbatojë masat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë inventarizimit me kulturë jouniforme

**RM 2 Nxënësi bën mbjelljen e shkurreve**

***Përmbajtja***

- Zgjedhja e veglave të punës
- Mbjellja me kunj
- Mbjellja me kanale
- Mbjellja me gropa
- Përcaktimi i thellësisë së gropës
- Hapja e gropës
- Përgatitja e fidanit për mbjellje
- Mbjellja e fidanit
- Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përzgjedhë veglat
- të bëjë mbjelljen me kunj
- të bëjë mbjelljen me kanal
- të mbjellë me gropa
- të përcaktojë thellësinë e gropës
- të hapë gropën
- të përgatisë fidanin
- të mbjellë fidanin
- të njohë rregullat e sigurimit teknik
- të zbatojë masat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë inventarizimit me kulturë jouniforme

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesionalë në parcelën pranë shkollës dhe në lulishtet publike.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë demonstrime konkrete të proceseve të punës në shumëzime me farë dhe pjesë vegetative.
- Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete për shumëzimin e luleve dhe shkurreve dekorative
- Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me proceset e ndryshme të punës. Gjatë vlerësimit të nxënësve bëhet verifikimi i shkallës së arritjes të shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në shumëzimin e luleve dhe shkurreve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mesuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Parcelë për kryerjen e praktikës
  - Farëra, material për shumëzim, copa rrënjore, gjethë, rizoma, kalema.
  - Uniformat e punës, vegla pune.
  - Katalogje etj.
-



## 8. Moduli “Punime me instrumenta matës gjeodezie”

Drejtimi: Pyje  
Profili: Florikulturë  
Niveli: III  
Klasa: 12

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME ME INSTRUMENTA MATES GJEODEZIE	M-25-646-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në përdorimin e instrumentave matës të gjeodezisë.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi përcakton pikat e poligonit në terren.</b> <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgimi i zonës që do rilevohet .</li><li>– Përcaktimi i vëndit të pikave të poligonit.</li><li>– Përpilimi i skicës së zonës.</li><li>– Përcaktimi i grupit të punës që do rilevojë.</li><li>– Zgjedhja e mjeteve matëse dhe të punës.</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përcaktimit të pikave të poligonit</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të vëzhgojë zonën që do rilevohet.</li><li>– të përcaktojë vendin e pikave të poligonit.</li><li>– të përpilojë skicat e zonës.</li><li>– të përcaktojë grupin e punës që do rilevojë.</li><li>– të zgjidhë mjetet matëse dhe të punës.</li><li>– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përcaktimit të pikave të poligonit</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi mat brinjët dhe këndet e poligonit.</b> <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Matja e brinjëve të poligonit në vajtje.</li><li>– Matja e brinjëve të poligonit në ardhje.</li><li>– Drejtimi i zhalonit gjatë matjes së brinjëve.</li><li>– Plotësimi i tabelës së matjeve në lartësi.</li><li>– Matja e këndeve të brëndëshëm të poligonit me Teodolit me saktësi 1gradë.</li></ul>	

- Përcaktimi i metodave të matjes së këndeve me një sasi të plotë.
- Matja e këndeve me dy pozicione dylbije.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë matjes së brinjëve dhe këndeve

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë brinjët e poligonit në vajtje.
- të matë brinjët e poligonit në ardhje.
- të drejtojë zhalonin gjatë matjes së brinjëve.
- të plotësojë tabelën e matjeve në lartësi.
- të masë kënde e brëndëshme të poligonit me teodolit.
- të përcaktojë metodat e matjes së këndeve .
- të matë këndet në dy pozicione dylbije.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë matjes së brinjëve dhe këndeve.

**RM 3 Nxënësi kryen punime nivelimi të pikave të poligonit.**

***Përmbajtja:***

- Zgjedhja e instrumentit nivelues.
- Përgatitja e niveluesit për punë.
- Nivelimi i pikave të poligonit duke përdorur metodën gjeodezike nga mesi.
- Plotësimi i librezave të nivelimit.
- Trasferimi i kuotës së pikës vajtje-ardhje.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë nivelimit të pikave të poligonit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zgjedhë instrumentin nivelues.
- të përgatisë niveluesin për punë.
- të nivelojë pika të poligonit duke përdorur metodën gjeodezike nga mesi.
- të plotësojë librezën e nivelimit.
- të transferojë kuotën e pikës vajtje - ardhje.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë nivelimit të pikave të poligonit.

#### **RM 4 Nxënësi kryen punime dhe matje në çdo pikë qëndrimi.**

##### ***Përmbajtja:***

- Caktimi i grupit të nivelimit.
- Përcaktimi i detyrave të anëtarëve të grupit.
- Vendosja e teodolitit në pe plumç.
- Vendosja e latave në pikat e qëndrimit..
- Matja e lartësisë për çdo pikë qëndrimi ( 4 pika)
- Orientimi i instrumentit matës.
- Marrja e pikave me detaje .
- Kryerja e leximit në lartësi.
- Kontrolli i punimeve për çdo pikë qëndrimi.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve dhe matjeve në pika qëndrimi.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të caktojë grupin e nivelimit.
- të përcaktojë anëtarët e grupit.
- të vendosë teodolitin në pozicion pune .
- të vendosë latat në pikat e qëndrimit.
- të masë lartësitë për çdo pikë qëndrimi.
- të orientohet me instrumentin matës.
- të matë pikat me detaje.
- të kryejë lexime në lartësi.
- të kontrollojë punimet për çdo pikë qëndrimi.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve dhe matjeve në pika qëndrimi.

## **RM 5 Nxënësi kryen hedhje të pikave në planshetë në zyrë**

### ***Përmbajtja:***

- Përcaktimi i letrës së vizatimit dhe mjeteve.
- Vendosja e pikave të qëndrimit në letrën e vizatimit me kordinatë ose raportor.
- Vendosja e pikave me detaje në letrën e vizatimit.
- Interpolimi i izoipseve
- Kontrolli i pikave të interpoluara.
- Vizatimi me tush i objekteve, izoipseve dhe rrjedhjeve ujore.
- Plotësimi i kornizës së planshetës.
- Matja e sipërfaqes së zonës me planimeter polar

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë llojin e letrës së vizatimit .
- të vendosë në letër pikat e qëndrimit me kordinatë ose raportor.
- të vendosë pikat me detaje në letrën e vizatimit.
- të realizojë interpolimin e izoipseve.
- të kontrollojë pikat e interpoluara.
- të vizatojë me tush objektet, izoipseve dhe rrjedhjet ujore.
- të plotësojë kornizën e planshetës
- të përcaktojë sipërfaqen e zonës me planimeter polar.

---

### **Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në zona pyjore.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të matjeve të sipërfaqeve pyjore dhe jo pyjore me Teodolit dhe nivelues, te demostroje plotesimin e tabelave të nivelimit dhe të matjeve me teodolit, te demostroje mbajtjen dhe leximin e lates në pikat e poligonit, te hedhe në planshet te dhenat e grumbulluara dhe të realizoje në zyrë mbylljen e poligonit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore, përcaktimin e sipërfaqeve pyjore për matje me teodolit dhe nivelues, përbilimin e tabelave dhe librit të nivelimit, matjen e pikave të poligonit dhe leximin me instrumenta matës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në përgatitjen e planshetës, hedhjen e pikave të poligonit në planshete si dhe matjen e sipërfaqes me planimeter polar.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe paisjeve..
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e matjeve gjeodezike në terren dhe në zyrë.

---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Sipërfaqe pyjore ose grumbull pyjor.
  - Mjete matëse gjeodezike, teodolit e nivelues, lata, planimeter polar, meter shirit
  - Komplete veshje e puntorit ne fushen e pyjeve..
  - Hipsometer, diameter mates, latë, zhalon .
  - Tabela te gatshme për hedhjen e të dhënave te grumbulluara nga matjet.
  - Harta dhe busull orjentuese.
  - Makine llogaritëse, kanceleri te ndryshme si flete vizatimi, leter kalk etj
-

## 9. Moduli “Llogaritjet ekonomike në florikulture ”

Drejtimi: Pyje  
Profili: Florikulture  
Niveli: III  
Klasa: 13

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	LLOGARITJET EKONOMIKE NE FLORIKULTURE	M-25-974-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer llogaritje ekonomike për aktivitetet pyjore	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12 të profilit mësimor “Florikulturë”.	

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e fidanëve.</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Llogaritja ekonomike për prodhimin e fidanëve.</li><li>– Hartimi i preventivit për punimet në prodhimin e fidanëve.</li><li>– Preventivi i materialeve, kostoja për materiale.</li><li>– Preventivi i shërbimeve, kostoja për shërbime.</li><li>– Kostot në punimet për prodhimin e fidanëve.</li><li>– Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqerore, etj).</li><li>– Kosto të tjera (transporti, energji, amortizim pajisjesh, etj)</li><li>– Detyrimet fiskale për prodhimin e fidanëve, llogaritja e tyre.</li><li>– Të ardhurat , fitimi, llogaritja e fitimit gjatë prodhimit të fidanëve.</li><li>– Përgatitja e faturës për proceset e kryera në prodhimin e fidanëve.</li><li>– Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.</li><li>– Marketingu i fidanëve (studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i çmimit, mënyrat e shpërndarjes së produktit, reklamës)</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të kryejë llogaritjet ekonomike për prodhimin e fidanëve</li><li>– të përcaktojë koston në punimet për prodhimin e fidanëve</li></ul>
---	---

- 
- të përcaktojë koston e punës(pagat, sigurimet shoqërore,etj)
  - të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh,etj)
  - të llogaritë detyrimet fiskale në prodhimin e fidanëve
  - të llogaritë të ardhurat, fitimin gjatë prodhimit të fidanëve
  - të hartojë preventivin (për materiale) përfundimtare për prodhimin e fidanëve
  - të përgaritë faturën për koston e fidanëve;
  - të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
  - të kryjë veprimtari të marketingut që lidhen me studimin e tregut të shitjes, përcaktimin e çmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit, reklamën.

## **RM 2 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e luleve.**

### ***Përmbajtja:***

- Llogaritja ekonomike për prodhimin e luleve.
- Hartimi i preventivit për punimet në prodhimin e luleve
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialeve.
- Preventivi i shërbimeve, kostoja për shërbime.
- Kostot në punimet për prodhimin e luleve.
- Kostoja e punës(pagat, sigurimet shoqërore,etj).
- Kosto të tjera (transporti, energji, amortizim pajisjesh,etj)
- Detyrimet fiskale për prodhimin luleve, llogaritja e tyre.
- Të ardhurat ,fitimi , llogaritja e fitimit për prodhimin e luleve .
- Përgatitja e faturës për proceset e kryer në prodhimin e luleve.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- Marketingu (studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i çmimit, mënyrat e shpërndarjes së produktit, reklamës)

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë llogaritjet ekonomike për prodhimin e luleve.
- të përcaktojë koston në punimet për prodhimin e luleve
- të përcaktojë koston e punës(pagat, sigurimet shoqërore,etj)
- të përcaktojë kosto të tjera(transport, energji, amortizim pajisjesh,etj)
- të llogaritë detyrimet fiskale në prodhimin e luleve
- të llogaritë të ardhurat, fitimin gjatë prodhimit të luleve
- të hartojë preventivin (për materiale) përfundimtar për prodhimin e luleve;

- të përgaritur faturën për koston e luleve
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- të kryejë veprimtari të marketingut që lidhen me studimin e tregut të shitjes, përcaktimin e çmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit, reklamën

### **RM 3 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e bimëve eterovajore.**

#### ***Përmbajtja:***

- Llogaritja ekonomike për prodhimin e bimëve eterovajore.
- Hartimi i preventivit për punimet në prodhimin e bimëve eterovajore
- Preventivi i materialeve, kostoja për materiale.
- Preventivi i shërbimeve, kostoja për shërbime.
- Kostot në punimet për prodhimin e bimëve eterovajore.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj).
- Kosto të tjera (transporti, energji, amortizim pajisjesh, etj)
- Detyrimet fiskale për prodhimin e bimëve eterovajore, llogaritja e tyre.
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit gjatë prodhimit të bimëve eterovajore.
- Përgatitja e faturës për proceset e kryer në prodhimin e bimëve eterovajore.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- Marketingu i bimëve eterovajore (studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i çmimit, mënyrat e shpërndarjes së produktit, reklamës)

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë llogaritjet ekonomike për prodhimin e bimëve eterovajore
- të përcaktojë koston në punimet për prodhimin e bimëve eterovajore
- të përcaktojë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj)
- të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj);
- të llogaritur detyrimet fiskale në prodhimin e bimëve eterovajore
- të llogaritur të ardhurat, fitimin gjatë prodhimit të bimëve eterovajore
- të hartojë preventivin (për materiale) përfundimtar për prodhimin e bimëve eterovajore
- të përgaritur faturën për koston e bimëve eterovajore



- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- të kryejë veprimtari të marketingut që lidhen me studimin e tregut të shitjes, përcaktimin e çmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit, reklamën

#### **RM 4 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për mbledhjen e bimëve mjeksore.**

##### ***Përmbajtja:***

- Llogaritjet ekonomike për mbledhjen e bimëve mjeksore.
- Hartimi i preventivit për punimet në mbledhjen e bimëve mjeksore.
  - Preventivi i materialeve, kostoja për materialev.
  - Preventivi i shërbimeve, kostoja për shërbime.
- Kostot në punimet për mbledhjen e bimëve mjeksore.
- Kostoja e punës(pagat, sigurimet shoqerore, etj).
- Kosto të tjera (transporti, energji, amortizim pajisjesh,etj)
- Detyrimet fiskale për prodhimin rrëshirës, llogaritja e tyre.
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit gjatë mbledhjes së bimëve mjeksore
- Përgatitja e faturës për proceset e kryera gjatë mbledhjes së bimëve mjeksore
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- Marketingu i bimëve mjeksore(studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i çmimit, mënyrat e shpërndarjes së produktit)

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë llogaritjet ekonomike për grumbullimin e bimëve mjeksore
- të përcaktojnë koston në punimet për mbledhjen e bimëve mjeksore
- të përcaktojnë koston e punës(pagat, sigurimet shoqerore, etj)
- të përcaktojnë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj)
- të llogaritë detyrimet fiskale në mbledhjen e bimëve mjeksore
- të llogaritë të ardhurat, fitimin për grumbullimin e bimëve mjeksore
- të hartojë preventivin (për materiale) përfundimtare për grumbullimin e bimëve mjeksore
- të përgaritë faturën për koston e grumbullimin e bimëve mjeksore
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- të kryejë veprimtari të marketingut që lidhen me studimin

e tregut të shitjes, përcaktimin e çmimit , mënyrën e shpërdarjes së produktit.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në klasë, pranë drejtorive të shërbimit pyjor në rreth, si dhe në biznese private në fushën e pyjeve .
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të llogaritjeve ekonomike.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve praktike për llogaritje të thjeshta ekonomike të hartimit të një plan biznesi të një aktiviteti pyjor si në aktivitete të grumbullimit të bimëve mjeksore, prodhimit të fidanave pyjore.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të plotësimit dokumentacionit të nevojshëm, ruajtjen e dokumentacionit të nevojshëm, analizën e këtyre dokumentacioneve dhe nxjerrjen e konkluzioneve të rëndësishëm financiar.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të ndryshme për realizimin e llogaritjeve të thjeshta ekonomike përcaktimin e çmimit , të kostos dhe fitimit të çdo produkti të përmendur më sipër.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Modele projektsh te aplikuar ne fushën e pyjeve.
  - Pajisje kancelarie.
  - Interneti
  - Makina llogaritëse dore.
  - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e pyjeve që lidhet me prodhimet pyjore(kodi i punës, legjislacioni fiskal).
  - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

## 10. Moduli “Ndërtimi i një konvejeri në lultari”

**Drejtimi:** Pyje  
**Profili:** Florikulturë  
**Niveli:** III  
**Klasa:** 13

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	NDERTIMI I NJE KONVEJERI NE LULTARI	M-25-975-13
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për ndërtimin e një konvejeri në lultari	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	33 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për praninë</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12 të profilit mësimor “Florikulturë”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Nxënësi kryen punime për prodhimin e luleve në pranverë</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Ndërtimi i skemës së luleve që do marrim</li><li>– Ndërtimi i grafikut të punimeve</li><li>– Zgjedhja e bimëve mëmë</li><li>– Zgjedhja e farave</li><li>– Parapërgatitja e farave</li><li>– Përgatitja e arkave për mbjellje</li><li>– Mbjellja e farave</li><li>– Artisja e bimëve</li><li>– Mbjellja në vendin e përhershëm</li><li>– Shërbimet kulturale</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë trajtimeve kimike.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të ndërtojë skemën e luleve që do të marrin</li><li>– të ndërtojë grafikun e punimeve</li><li>– të zgjedhë bimët mëmë</li><li>– të zgjedhë farat</li><li>– të bëjë parapërgatitjen e farave</li><li>– të përgatisë arkat për mbjellje</li><li>– të bëjë mbjelljen e farave</li><li>– të bëjë artisjen e bimëve</li><li>– të mbjelljë në vendin e përhershëm</li></ul>	

- 
- të bëjë shërbimet kulturale
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë trajtimeve kimike

## **RM 2 Nxënësi kryen punime për prodhimin e luleve në verë**

### ***Përmbajtja:***

- Ndërtimi i skemës të luleve që do marrim
- Ndërtimi i grafikut të punimeve
- Zgjedhja e mënyrës së shumëzimit
- Përgatitja e farës
- Mbjellja e farës
- Shërbimet e fidanit
- Mbjellja në vendin e përhershëm
- Shërbimet pas mbjelljes
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të ndërtojë skema të luleve
- të ndërtojë grafikun e punimeve
- të zgjedhë mënyrat e shumëzimit
- të përgatisë farën
- të mbjellë farën
- të bëjë shërbimet e fidanit
- të mbjellë në vendin e përhershëm
- të bëjë shërbimet pas mbjelljes
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në dhe ato të mbrojtjes së mjedisit gjatë damkosjes së drurit

## **RM 3 Nxënësi kryen punimet për prodhimin e luleve vere-vjeshtë**

### ***Përmbajtja:***

- Ndërtimi i skemës së luleve që do të prodhojmë
- Ndërtimi i grafikut të punimeve që do kryejmë
- Zgjedhja e farave që do mbjellim
- Përgatitja e arkave për mbjellje
- Mbushja e arkave me dhe
- Mbjellja e farave në arka
- Artisja e bimëve
- Mbjellja në vendin e përhershëm
- Shërbimet në vendin e përhershëm
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të bëjë ndërtimin e skemës së luleve që do prodhojnë
- të bëjë ndërtimin e grafikut të punimeve që do kryejë
- të zgjedhë farat që do mbjellë
- të përgatisë arkat për mbjellje
- të mbushë arkat me dhe
- të mbjellë farat në arka
- të artisë bimët
- ti mbjellë në vendin e përhershëm
- të bëjë shërbimet në vendin e përhershëm
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në parcelën e shkollës dhe në fidanishtete qytetit.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të mbledhjes së farërave, të pastrimit të tyre, të zgjedhë bimët mëmë, të përcaktojë pjekurinë e farave, të njohë tharjet e farave, të njohë mënyrat e ruajtjes së farave, të bëjë dizinfektimin e farave, të ndërtojë skema të mbjelljes të luleve, të ndërtojë grafikun e punimeve, të mbushë arkat me dhe, të bëjë artisjen e bimëve, ti mbjellë në vendin e përhershëm, të bëjë shërbime në kohë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në ndërtimin e skemave të ndryshme, në njohjen e biologjisë së luleve, të njohë kohën e prodhimit të tyre, të njohë shërbimet që iu bëhen, të dijë të ndërtojë grafikë të punimeve.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe paisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimin e prodhimit të luleve në kohë të ndryshme.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Sipërfaqe me lule dhe mjete të mbrojtura.
  - Mjete pune të ndryshme, arka, dherishte.
  - Komplete veshje e puntorit për punime të ndryshme.
  - Farëra, fruta të luleve, kalendar, grafikë.
-

## 11. Moduli “Grumbullimi i farërave dhe zhardhokëve”

Drejtimi: Pyje  
Profili: Florikulturë  
Niveli: III  
Klasa: 13

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	GRUMBULLIMI I FARERAVE DHE ZHARDHOKEVE	M-25-976-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për grumbullimin e farërave dhe zhardhokëve	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12 të profilit mësimor “Florikulturë”.	
